



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:066964
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05508211

KPPP.nr.1325/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbareme të kreditorit “GLOBI M.P” Sh.P.K., me seli në Gjiilan, rruga e Ferizajit, me NUI: 810110099, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.M. avokat nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Kamenicës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr.230/23 të datës 04.08.2023, të Përmbaremit Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 18.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Kamenicës, ANULOHET Urdhri Përmbareme P.nr.230/23 i datës 04.08.2023, i nxjerrë nga Përmbaremit Privat Flamur Bogaj.

A r s y e t i m

Përmbaremit Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.230/23 të datës 04.08.2023, duke lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.23-360-0003 të datës 22.06.2023, me të cilin e ka detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumë prej 66,008.40 Euro, me kamatëvonesë ligjore 8%, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbareme, nën kërcënim të përmbaremit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se dokumentet e besueshme në bazë të të cilave është lejuar përmbarimi nuk përmbajnë elementet e domosdoshme të cilat i parasheh neni 29 par.3 i LPP-së. Më tej ka theksuar se faturat në bazë të së cilave është inicuar procedura përmbarimore nuk janë dorëzuar dhe pranuar në mënyrë të rregullt, dhe si të tilla nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë. Ka shtuar se çdo kërkesë që dorëzohet tek debitori, domosdoshmërisht protokollohet në zyrën përkatëse, i vendoset vula katrore, numri i protokollit dhe nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës me rastin e pranimit, ndërsa në rastin konkret faturat nuk janë të protokolluara, nuk përmbajnë vulën dhe numrin e protokollit, prandaj si të tilla nuk mund të konsiderohen dokumente të besueshme. I ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, dhe të anulohet urdhri përmbarimor P.nr.230/2023 i datës 04.08.2023.

Kreditore në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, me arsyetimin se fatura i ka të gjitha elementet e kërkuara me LPP, konkretisht nenin 29 par.3. Më tej ka theksuar se nuk qëndron as pretendimi se fatura nuk i është dorëzuar debitorit, ngase kjo vërtetohet nga provat e bashkangjitura propozimit për përmbarim dhe atë: Prova 4.2 Formulari i dorëzimit të faturës 23-360-003 dhe kërkesës për pagesë drejtuar menaxherit të projektit me nr.protokolli 02-030/01-0020335/23 e datës 22.06.2023, si dhe Prova 4.3 Formulari me nr.protokolli 09-352/01-0021821/23 e datës 05.07.2023. Ka shtuar se as në kontratën e prokurimit të datës 05.02.2020 që e kanë lidhur palët ndërgjyqëse, nuk është paraparë fakti që faturat të konsiderohen si të dorëzuara, të jenë të protokolluara dhe nënshkruara, apo vetëm njëra nga to, por në mënyrë të përgjithshme për të gjitha komunikimet (përfshirë këtu edhe dorëzimin e faturave), është paraparë se do të konsiderohen të rregullta në rast se kreditore i paraqet qoftë te Autoriteti Kontraktues (debitori) apo tek Menaxheri i Projektit, pra cilido prej tyre. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pathemeltë prapësimi i debitorit, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm” dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura nr.23-360-0003 e datës 22.06.2023, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit-debitorit.

Duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbartimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1325/23, më datë 18.03.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.